



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Sh.II.nr.1675/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit “Artmotion”, Sh.P.K me numër regjistrimi 71364887, me seli në Prishtinë, Rruga “Lidhja e Pejës”, Zona Industriale, përfaqësuar nga drejtori V.Sh., kundër të paditurit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 2310/840/KPM/JU të datës 03.10.2023 dhe Vendimit Nr.2310/889/BA/YF të datës 11.10.2023 dhe propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.501/2023 të datës 07.11.2023 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit “Artmotion”, Sh.P.K me numër regjistrimi 71364887, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.501/2023 i datës 07.11.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.501/2023 të datës 07.11.2023, është refuzuar si i pabazuar propozimi i paditësit “Artmotion”, Sh.P.K me të cilin ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit Nr. 2310/840/KPM/JU të datës 03.10.2023 dhe Vendimit Nr.2310/889/BA/YF të datës 11.10.2023 të nxjerra nga i padituri Komisioni i Pavarur i Mediave.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me ankesë ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të themeltë dhe ta anulojë aktvendimin e Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KA.nr.501/23 të datës 07.11.2023.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi “Artmotion” Sh.P.K., në gjykatën e shkallës së parë ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Vendimit Nr. 2310/840/KPM/JU të datës 03.10.2023 dhe Vendimit Nr.2310/889/BA/YF të datës 11.10.2023 të nxjerra nga i padituri Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tyre, deri në marrjen e vendimit gjyqësor përfundimtar për padi.

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.501/2023 të datës 07.11.2023, e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e paditësit “Artmotion”, Sh.P.K me të cilin ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit Nr. 2310/840/KPM/JU të datës 03.10.2023 dhe Vendimit Nr.2310/889/BA/YF të datës 11.10.2023 të nxjerra nga i padituri Komisioni i Pavarur i Mediave.

Gjykata e Shkallës së parë në pasi ka vlerësuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe shkresat e lëndës, ka vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar kërkesën e paditësit pasi që pretendimet e paraqitura në kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimi nuk kanë mbështetje ligjore, ashtu që nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, kusht ky i përcaktuar në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sipas arsyeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë në vendimin kontestues, pretendimet e paditësit se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik janë të pabaza, pasi që gjykata ka vlerësuar se me transmetimin e mesazheve me përmbajtje tekstuale dhe audiovizuale “Do të kujtojmë” dhe “Lavdi heronjve” është cenuar interesi publik, andaj edhe shtyrja e ekzekutimit të vendimeve kontestuese do të ishte në kundërshtim me interesin publik.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me dispozitën e Nenit 22 par.2 të LKA është paraparë që shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ mund të bëhet nën plotësimin e kushteve si në vijim: a) ekzekutimi i aktit administrativ do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik, c) shtyrja nuk do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare.

Bazuar në rrethanat e rastit konkret, Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejtë dispozitën e nenit 22 par.2 të LKA-së duke dhënë arsye të mjaftueshme ligjore dhe ka balancuar drejtë kërkesën e palëve në raport me kriteret ligjore. Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, lidhur me pretendimin e paditësit se me ekzekutimin e vendimeve kontestuese të njëjtit do të i shkactohej dëm vështirë i riparueshëm, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se edhe përkundër që paditësit mund t’i shkactohej dëm eventual me lënien në fuqi të aktit administrativ, një gjë e tillë mund të riparohet përmes kompensimit adekuat si mundësi ligjore e palës në procesin administrativ.

Përkitazi me kushtet ligjore që kanë të bëjnë me interesin publik dhe dëmin eventual që mund t'i shkaktohet palës së paditur, është qëndrim i Kolegjit se në rastin konkret, publikimet që janë transmetuar në kanalet televizive që janë objekt i urdhëresës së paditurës me vendimin kontestues, pa mëdyshje cenojnë interesin publik. Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se përmbajtja programore e kufizuar me vendimet kontestuese ka shprehur hapur cenim për sigurinë kombëtare dhe integritetin territorial përmes mbështetjes dhe promovimit të akteve terroriste në përmbajtjet audiovizuale dhe tekstuale të transmetuara në kanalet "Arena Sport".

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozuesit - paditësit në ankesë, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se me rastin e shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, gjykata shqyrton dhe kufizohet vetëm në kushtet ligjore nga Neni 22 par. 2 i LKA-së, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative në mënyrë që të shtyhet ekzekutimi i aktit administrativ. Andaj, Kolegji vlerëson se në rastin konkret pretendimet e paditësit janë të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale e kanë shqyrtuar ankesën edhe sa i përket pretendimeve ankimore për mos arsyetimin e bazave nga Neni 22 i LKA-së, në drejtim të shkeljeve të Nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenit 6 të KEDNJ.

Gjykata, duke iu referuar Nenit 10 të KEDNJ, si dhe jurisprudencës së GJEDNJ vë në pah faktin se liria e shprehjes e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 10 përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj (*Lingens kundër Austrisë*, § 41). Me nenin 10 par.1 të KEDNJ është parashikuar ndër të tjera e drejta e shteteve që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit, televizionit ose kinemasë.

Gjykata vlerëson se respektimi i parimit të pluralizmit në fushën e transmetimeve audiovizive, nënkupton gjithashtu një detyrë të shtetit për të siguruar, së pari, që publiku të ketë akses nëpërmjet televizionit dhe radios në informacione të paanshme dhe të sakta dhe një sërë opinionesh dhe komente, duke reflektuar ndër të tjera diversitetin e pikëpamjeve politike brenda vendit (Manole dhe të tjerët kundër Moldavisë, § 20). Sipas GJEDNJ, ndonëse kufizimi i licencës mund të çojë në ndërhyrje, qëllimet do të jenë legjitime sipas Nenit 10 par 2. të KEDNJ-së për "*kufizimet ose gjobat siç janë të përcaktuara me ligj dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, për interesat kombëtare, sigurinë, integritetin territorial ose sigurinë publike, për parandalimin të çrregullimit apo krimin, për mbrojtjen e shëndetit apo moralit, për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të tjerëve, për parandalimin zbulimin e informacionit të marrë në fshehtësi, ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit*".

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka bërë balancim të drejtë në mes të të drejtave të paditësit për të ushtruar lirshëm

veprimtarinë e saj të siguruar përmes licencave përkatëse të lëshuara nga e paditura, si dhe interesit publik dhe të drejtës legjitime të një shoqërie demokratike për t'u mbrojtur nga aktivitetet e organizatave terroriste (Zana v. Turkey, § 55; Karataş v. Turkey, § 51; Yalçın Küçük v. Turkey, § 39; İbrahim Aksoy v. Turkey, § 60).

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar propozimin e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese të KPM - Vendimit Nr. 2310/840/KPM/JU të datës 03.10.2023 dhe Vendimit Nr.2310/889/BA/YF të datës 11.10.2023. Në rrethanat e rastit konkret, është jokontestues fakti se deri te marrja e vendimit Ref.nr.2310/840/KPM/JU, ka ardhur si pasojë e publikimeve të transmetuara në kanalet “Arena Sport” me përmbajtje tekstuale dhe audiovizuale “*Do të kujtojmë*”, “*Lavdi heronjve*”, të cilat mbështesin dhe glorifikojnë sulmin terrorist të grupit i cili ka cenuar interesin kombëtar dhe sigurinë e përgjithshme të Republikës së Kosovës. Publikimi i përmbajtjeve të tilla që synojnë promovimin e akteve terroriste dhe veprimeve që mund të nxisin dhunë shtesë në Republikën e Kosovës, pa mëdyshje paraqesin veprim kundër interesit publik. Ndërkaq, paditësi tani për tani, me asnjë provë nuk ka arritur të sigurojë se publikimet e tilla nuk do të përsëriten apo në çfarëdo mënyre mund të kufizohen. Në këtë kontekst, vendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë me të cilin është refuzuar kërkesa për shtyrje të ekzekutimit, paraqet vendim procedural të përkohshëm i cili synon të sigurojë se përmbajtjet që nxisin mbështetje për veprimet terroriste të mos publikohen deri në zgjidhjen e çështjes kryesore.

Andaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura, dhe se nuk i ka konstatuar drejtë faktet, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Përkitazi me arsyet e dhëna, kolegji vlerëson se ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1675/2023, me datë 21.12.2023

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova